

BE-ja për Kosovën:

PËRKRAHJA NË
RRUGËTIMIN DREJT
BASHKIMIT EVROPIAN



NËNTOR 2017.
PRISHTINË, KOSOVË

Përmbajtja

**HYRJE: BE-ja NDRYSHON
JETËT NË KOSOVË**

FAQE: 5

**FUQIZIMI I GRAVE
NDËRMARRËSE**

FAQE: 6-10

**RRITJA E TURIZMIT
PËRMES ZHVILLIMIT RURAL**

FAQE: 11-14

**NJË SHIJE E KOSOVËS
PËR BOTËN**

FAQE: 15-17

**FORCIMI I GRUPEVE
TË CENUESHME**

FAQE: 18-20

**PËRKRAHJA E TOLERANCËS
PËRMES MBROJTJES SË
TRASHËGIMISË**

FAQE: 21-23

**INFRASTRUKTURË MË E
MIRË PËR NJË JETË MË
TË MIRË**

FAQE: 24-26

**SHANSI I DYTË PËR TË
MITURIT E KOSOVËS**

FAQE: 27-29



Hyrje: **BE-ja ndryshon jetët në Kosovë**



Nataliya Apostolova,
Shefe e Zyrës së BE-së në
Kosovë/Përfaqësuese e
Posaçme e BE-së

Mbështetja e BE-së për Kosovën po i ndryshon jetët e njerëzve. Bashkimi Evropian shpërndan shumë më të madhe të parave për kokë banori në krahasim me pjesën tjetër të botës, dhe mbetet donatori më i madh. Që nga viti 1999, Kosova ka marrë më shumë se 2,5 miliardë euro ndihmë nga BE-ja. Kjo asistencë, e zbatuar përmes Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit (IPA), e mbështet Kosovën në rrugën e saj evropiane. Por, për më tepër, ajo mbështet njerëzit që dëshirojnë ta shohin komunitetin e tyre në gjendje më të mirë, të zhvilluar dhe me më shumë mundësi.

Shembuj të tillë të mirë janë gratë e kooperativës 'Eva' në komunën e Klinës, të përfshira në mbarështimin e derrave dhe përpunimin e mishit, ose ato në Krushë të Madhe që tani eksportojnë ajvarin e tyre të famshëm përtej kufijve. Qasja në furnizim të besueshëm me ujë të pastër është thelbësore për jetesë, dhe është diçka që qytetarët e Kosovës po e shijojnë gjithnjë e më shumë falë asistencës së BE-së. Kamenica dhe Lipjani janë komuna ku komunitetet fetare janë të përkushtuara për të përmirësuar tolerancën ndër-

komunitare dhe respektin për identitetin kulturor nëpërmjet mbrojtjes së tij. Ndërkohë, Novobërda është shndërruar në lokalitet turistik. Nëse vendosni të shkoni atje, tani mund ta shihni dhe të ngjiteni në Kalanë e restauruar që daton nga shekulli i 13-të, apo të kalëroni ose të ecni në pyllin e "Gërshetat Resort." Asistenca e BE-së ka ndihmuar edhe në mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT. Edhe të miturit e dënuar me masa edukimi tani kanë një strukturë ku mund të marrin arsimimin dhe trajnimin e duhur, që u ndihmon të riintegrohen me lehtësi në shoqëri.

Në këtë botim, ne paraqesim tregime dhe dëshmi të njerëzve, jeta e të cilëve ka ndryshuar për të mirë, në një mënyrë apo tjetrën. Jemi mirënjohës dhe krenarë që jemi pjesë e këtij udhëtimi drejt një jete më të mirë.

Fuqizimi i grave ndërmarrëse

VEJUSHAT E KRUSHËS SË MADHE JANË TASHMË TË NJOHURA SI ZONJA TË ZELLSHME QË PËRPIQEN T’I KAPËRCEJNË TRAGJEDITË E TYRE TË LUFTËS DUKE KULTIVUAR TOKËN NË MËNYRË QË TË MBËSHTESIN FAMILJET E TYRE DHE TË LEHTËSOJNË DHIMBJEN. FSHATI HUMBI MË SHUMË SE 100 BURRA GJATË LUFTËS NË VITIN 1999.



“Do të doja të falënderoja BE-në për shtrirjen e mbështetjes së tyre ndaj kësaj kategorie të grave që humbën djemtë dhe burrat gjatë luftës. Me këtë mbështetje, BE u ka siguruar atyre të ardhurat.”

Fahrije Hoti,
drejtoreshë e
kooperativës
‘Krusha.’

Pasi kërkuar të dashurit e tyre për vite me radhë, këto gra e kuptuan se duhet të bëjnë më shumë për të mbijetuar. Ato vendosën t’i futen punës që e njohin më mirë: përpunimit të perimeve. Sot, ajvari, specat e mbushur me lakër dhe specat në ajkë janë ndër produktet më të famshme të kooperativës ‘Krusha.’

Deri në vitin 2013, gratë e kooperativës ‘Krusha’ punonin në shtëpi private pa kushte të përshtatshme, por falë projektit të financuar nga BE-ja, tani ato kanë një strukturë të përpunimit të ushqimit prej 200 m². Kjo e ka përmirësuar ndjeshëm ambientin e tyre të punës.

“Pas marrjes së objektit të ri, arritëm të shtojmë numrin e punëtoreve në sektorin e prodhimit nga 23 në 70. Përveç kësaj,



kemi gjashtë grupe që punojnë individualisht në familjet e tyre për furnizimin e kooperativës sonë,” thotë Fahrije Hoti, drejtoreshë e kooperativës ‘Krusha.’

Ndihma e BE-së prej mbi 50.000 eurosh kontribuoi në shtimin e prodhimit dhe në rritjen e numrit të kontratave me mbi 70 fermerë nga rajoni i Rahovecit.

“Kjo strukturë e ka siguruar tregun tonë tani. Sot, mbi 200 dyqane në të gjithë Kosovën shesin produktet tona. Kemi arritur edhe të lidhim kontrata me Zvicrën dhe Gjermaninë për shitjen e prodhimeve tona jashtë Kosovës. Dhe jemi ende në rritje,” shtoi Hoti.

Gratë e Krushës janë të lumtura që e kanë këtë punë për të mbështetur familjet e tyre. Megjithatë, ky është edhe një vend ku përmes punës dhe bisedave ato lehtësojnë dhimbjet nga e kaluara.

Besire Duraku, e cila humbi bashkëshortin gjatë luftës, mbështet dy fëmijët e saj studentë në universitet, me punën e saj në kooperativën Krusha. Gjatë sezonit të pushimeve, edhe fëmijët e saj punojnë në kooperativë. Ajo punon nga ora 10 deri në orën 6 pasdite, dhe gjatë kohës së sezonit kooperativa punon me dy ndërrime deri në mesnatë.



“Kjo punë më ka bërë mirë për trupin, mendjen dhe familjen time. Falë investimit, tani kemi kushte shumë më të mira, jemi shtuar dhe ka më shumë hapësirë pune,” thotë Duraku.

“Do të doja të falënderoja BE-në për shtrirjen e mbështetjes së tyre ndaj kësaj kategorie të grave që humbën djemtë dhe burrat gjatë luftës. Me këtë mbështetje, BE-ja ka siguruar të ardhurat e tyre mujore.” përfundon drejtoresha e kooperativës, Fahrije Hoti.

Dokumenti Strategjik Indikativ për Kosovën, i cili përshkruan qasjen strategjike të ndihmës IPA II për Kosovën për periudhën 2014-2020, parashikon vazhdimin e mbështetjes me grante për ndërmarrjet e vogla dhe bizneset fillestare, duke u fokusuar në modelet inovative të biznesit, shërbimet e orientuara drejt eksportit dhe gratë ndërmarrëse.

Një mbështetje e tillë, ndër të tjera, ndihmoi gratë e kooperativës ‘Krusha’ në rajonin e Rahovecit dhe gratë e kooperativës ‘Eva’ në komunën e Klinës.

Tatjana Iliq është lindur në Prishtinë, por nuk kishte jetuar kurrë në Kosovë. Për vite me radhë, ajo jetonte në Serbi. Burri i saj, i cili është lindur në Videjë, komuna e Klinës, vendosi të kthehet në vendlindjen e tij në vitin 2005, kështu që ajo erdhi me të. Iliq është një përfituese tjetër e asistencës së BE-së dhe tani drejton kooperativën ‘Eva,’ që merret me mbarështimin e derrave dhe aktivitetet e përpunimit të mishit, duke punuar me një përzgjedhje të fermave të vogla të mbarështimit nga rrethina. Asistenca ndihmoi në krijimin e prodhimit, zhvillimin e tij, marketingun dhe brendimin rajonal.

Sipas dokumentit strategjik IPA II për Kosovën, përfshirja dhe pjesëmarrja e grave mbetet sfida kryesore në të gjitha nivelet e shoqërisë. Për më tepër, gratë nga komunitetet pakicë përfaqësojnë grupet më të përjashtuara shoqërore. Kështu, fuqizimi i tyre varet nga përmirësimi i edukimit, shëndetësisë dhe pjesëmarrjes ekonomike. Asistenca e BE-së ka ndihmuar edhe gratë që vijnë nga komunitete të ndryshme.

Projekti i quajtur ‘Veprimi i Grave në Agrobiznes,’ me vlerë 449.856 euro, u zbatua nga organizata italiane Reggio Terzo Mondo (RTM) nga dhjetori 2014 deri në dhjetor 2016.

“Me mbështetjen financiare, BE-ja na ka ndihmuar shumë. Kjo ndihmë i fuqizoi gratë në këtë rajon, ato u bënë të pavarura dhe ndihen më të forta dhe më mirë.”
Tatjana Iliq,
drejtoreshë e
kooperativës ‘Eva.’





Iliq thotë se gratë bëjnë të gjitha punët në këtë kooperativë, përveç therjes së derrave.

“Ne ishim shumë këmbëngulëse me idenë tonë për përpunimin e mishit. Falë kësaj ndihme dhe me mbështetjen e RTM-së, e regjistruam kooperativën tonë me emrin ‘Eva’. Tani kemi një fabrikë ku punojnë katër gra, dhe gjithashtu kemi dy kasapë. Kemi 12 stalla me derra ku punojnë 12 gra. I shesim produktet tona të mishit në tregun vendas,” tregon Iliq.

‘Eva’ furnizon katër restorante në rajonin e Klinës, si dhe disa restorante në Gjakovë dhe Prishtinë.

Iliq shton se pa ndihmën e BE-së, këto gra kurrë nuk do të kishin arritur pikën ku janë sot.

“Me mbështetjen financiare, BE-ja na ka ndihmuar shumë. Kjo ndihmë i fuqizoi gratë në këtë rajon; ato u bënë të pavarura dhe ndihen më të forta dhe më mirë.” Për më tepër, është përmirësuar edhe jeta jonë shoqërore. Jemi së bashku në të mira dhe të këqija. Unë jam 52 vjeçe, por ky është vendi ku takova miqtë e mi më të mirë. Kjo është e gjitha në sajë të mbështetjes së BE-së,” shton ajo.

Falë dhënies së gati gjysmë milioni euro nga BE-ja, Iliq tani e sheh të ardhmen e saj në Kosovë, pranë bashkëpunëtorëve të saj nga komuniteti serb dhe ai shqiptar, të cilët ajo i konsideron tashmë pjesë të familjes.

Kolegia e saj, një shqiptare e Kosovës, Tone Gjergjaj, e konfirmon këtë.

“Ia kalojmë shumë mirë. Jemi si motra. Kjo është e gjitha falë BE-së që na ndihmoi me këtë kooperativë. Të ardhurat na ndihmojnë të mbështesim familjet tona, t’i edukojmë fëmijët tanë. Jemi shumë të kënaqura me mbështetjen e dhënë, por edhe sepse klientët tanë janë të kënaqur me produktet tona. Kjo na jep më shumë vullnet për të punuar.” shton Gjergjaj.

Përveç krijimit të vendeve të punës, ky projekt gjithashtu ndihmoi fermerët lokalë nga rajoni, të cilët furnizojnë fabrikën me produkte të blegtorisë.

“Ia kalojmë shumë mirë. Jemi si motra. Kjo është e gjitha falë BE-së që na ndihmoi me këtë kooperativë. Të ardhurat na ndihmojnë të mbështesim familjet tona, t’i edukojmë fëmijët tanë. Jemi shumë të kënaqura me mbështetjen e dhënë, por edhe sepse klientët tanë janë të kënaqur me produktet tona. Kjo na jep më shumë vullnet për të punuar.”

**Tone Gjergjaj,
punëtoare në
kooperativën ‘Eva.’**

Rritja e turizmit përmes zhvillimit rural

KALAJA E NOVOBËRDËS ISHTE HARRUAR PËR VITE ME RADHË DHE MEZI DALLOHEJ. E NGRITUR NË SHEKULLIN E 13-të, ËSHTË MONUMENTI KRYESOR I TRASHËGIMISË KULTURORE TË NOVOBËRDËS, NË PJESËN JUGLINDORE TË KOSOVËS. GJATË PERIUDHËS MESJETARE, KY VEND ISHTE NJË NGA QYTETET MË TË PASURA DHE QENDRAT TREGTARE MË TË MËDHA NË BALLKAN, ME MINIERA TË PASURA ME AR DHE ARGJEND.

Falë IPA 2013, u ndanë 1 milion euro për rivitalizimin e kështjellës, përmes projektit të zbatuar nga UNESCO-ja, ndërsa rivitalizimi i mjedisit të biznesit përreth kështjellës është ende në vazhdim me një buxhet shtesë prej 1 milion eurosh.

“Kishim një kala në zhdukje dhe tani kemi një formë të qartë të kalasë,” thotë Fitim Bunjaku, një udhërrëfyes lokal turistik, i cili ishte i përfshirë në zbatimin e projektit. Që nga përfundimi i rivitalizimit të kalasë në vitin 2016, numri i vizitorëve është rritur për 50 për qind.

Kalaja e Novobërdës, në majë të bjeshkës 1.124 m mbi nivelin e detit, u ndërtua gjatë sundimit të princit Lazar; ajo u fortifikua më vonë në shekullin e 14-të nga pashai turk Sufi Sinan Pasha. Në rrethinat e saj janë një numër monumentesh të tjera, siç janë: mbetjet e katedrales së lashtë, kisha e Shën Mërisë, një xhami shumë e vjetër, një teqe, një varrezë turke. Sot, me qytetin e saj të Epërm dhe të Poshtëm, Kalaja përfaqëson pasurinë më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore të kësaj komune.

Qyteti i Epërm përbëhet nga gjashtë kulla, por gjatë rivitalizimit u zbuluan objekte të reja brenda kështjellës, si: një kishë e vogël, hamami, rezervuarë uji dhe një hyrje drejt një kulle.

“Kishim një kala në zhdukje dhe tani kemi një formë të qartë të kalasë.”
Fitim Bunjaku,
udhërrëfyes lokal turistik.



Më parë, besohej se kalaja ishte bosh brenda. Ekziston gjithashtu mundësia për t'u ngjitur në muret e kalasë, nga ku keni një pamje të mrekullueshme mbi Novobërdën dhe atraksionet përreth.

Bunjaku shton se rivitalizimi i kalasë nuk mund të ishte bërë vetëm me fondet e buxhetit të Kosovës, prandaj ndihma e BE-së ishte e një rëndësie vendimtare.

Ai pret që me zbatimin e pjesës tjetër të projektit, e cila parashikon rivitalizimin e mjedisit të biznesit rreth kalasë, këto vende do të kontribuojnë në zhvillimin e turizmit rural dhe kulturor dhe të ekonomisë.

Kalaja tashmë është duke u vizituar nga vizitorët ndërkombëtarë, por është gjithashtu e popullarizuar në mesin e diasporës kosovare.

Një projekt tjetër i financuar nga BE-ja ka kontribuar në zhvillimin e turizmit lokal në komunën e Novobërdës.

Rreth 18 km nga Novobërda, në fshatin Strazhë, gjendet 'Gërsheta Resort.' Në kuadër të projektit 'Zhvillimi i kapaciteteve turistike në Rajonin Lindor të Kosovës,' granti rural i BE-së ka sjellë ndryshim në komunitetin lokal, ka krijuar vende të reja pune dhe ka ndihmuar ekonominë e fermerëve përreth.



Falë ndihmës së BE-së, "Gërsheta Resort" u ofron vizitorëve të saj shtigje të ecjes rreth 20 km, aktivitete sportive, kalërim, shesh lojërash për fëmijë, kamping, biçikleta, dhe një restorant dhe kabina me pamje nga bjeshka.

Afrim Hasani, pronar i këtij biznesi në pronësi familjare, thotë se vendpushimi është ndërtuar nga zeroja falë një ndihme prej gjysmë milioni eurosh nga BE-ja.

"Askush nuk besonte se në këtë peizazh kodrinor mund ta ndërtonim një resort të këtillë pushimesh," thotë Hasani.

Qendra punëson 60 persona nga rrethinat dhe ka kontraktuar 15 fermerë lokalë për ta furnizuar resortin me ushqim të freskët, pasi i ndihmuan me grante të vogla. Hasani ende kërkon të punësojë më shumë njerëz dhe t'i trajnojë për punë.

Klientët dhe punonjësit e 'Gërsheta Resort' vijnë nga komunitetet shqiptare dhe serbe.

Abide Ramadani nga Gjilani punon si kontabiliste në këtë resort. Ajo thotë se njerëzit nga jashtë po e rezervojnë këtë resort turistik përmes internetit.

"Ne duhet të vazhdojmë më tej me investime, të investojmë në një qendër skijimi, që të mund të tërheqim turistë edhe gjatë dimrit" shton ajo.

Spektori i bujqësisë dhe zhvillimit rural është një nga çelësat për asistencën e IPA II, sepse luan një rol të rëndësishëm në sigurimin

"Askush nuk besonte se në këtë peizazh kodrinor mund ta ndërtonim një resort të këtillë pushimesh."

**Afrim Hasani,
pronar i 'Gërsheta
Resort'**

'GËRSHETA RESORT' U OFRON
VIZITORËVE TË SAJ SHITIGJE TË
ECJES, AKTIVITETE SPORTIVE, SHESH
LOJËRASH PËR FËMIJË, KAMPING,
BIÇIKLETA DHE KALËRIM

BE-ja për Kosovën: Përkrahja në rrugëtimin drejt Bashkimit Evropian



e mundësive për punësim dhe gjenerimin e të ardhurave. Mbështetja për këtë sektor është një nga pesë fushat e politikave për ndihmën financiare të IPA II.

Programi i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural i Kosovës 2014-2020 është në përputhje me rregulloren e IPA II dhe ndjek përparësitë e IPA-s në rritjen e qëndrueshmërisë dhe konkurrencës së fermave; restaurimin, ruajtjen dhe rritjen e ekosistemeve; promovimin e përfshirjes sociale dhe ekonomike; transferimin e njohurive dhe inovacionit.

Qëllimi i përgjithshëm i asistencës së IPA II në këtë sektor është të mbështesë institucionet e Kosovës të harmonizojnë dhe zbatojnë Politikën e Përbashkët Bujqësore, duke përfshirë përmirësimin e standardeve të jetesës së popullsisë rurale të Kosovës.

“Ne duhet të vazhdojmë më tej me investime, të investojmë në një qendër skijimi, që të mund të tërheqim turistë edhe gjatë dimrit.”
Abide Ramadani,
kontabiliste në
‘Gërsheta Resort’

Një shije e Kosovës për botën

NË JUGPERËNDIM TË KOSOVËS, RAHOVECI ËSHTË I NJOHUR PËR RRUSHIN E TIJ DHE KA QENË RAJONI KRYESOR I VERËS NË KOSOVË PËR VITE ME RADHË. KOMPANIA E PËRPUNIMIT TË VERËS “BIOPAK” ËSHTË KOMPANIA E PARË NË KOSOVË NË BIZNESIN E VERËS. ATA FILLUAN NË VITIN 2001, ME EMRIN ‘RAHOVECI’, I CILI MË VONË U NDRYSHUA NË ‘BIOPAK,’ DHE KOMPANIA U BË E NJOHUR PËR DY MARKAT E SAJ: ‘ILLYRIAN’ DHE ‘MURATTI.’

Illyrian është e pranishme në tregun e Kosovës që nga viti 2001, ndërsa ‘Muratti’ u krijua në vitin 2010, si verë e një cilësie më të mirë, e dedikuar për eksport.

Sot, “Biopak” eksporton 90 për qind të verës së prodhuar çdo vit në vendet e BE-së, si dhe në Japoni.

Asistenca e BE-së prej pothuajse gjysmë milioni eurosh ka luajtur një rol të madh, çka rezultoi me rritjen e cilësisë së verës dhe prodhimit të saj, si dhe stabilizimin e tregut të brendshëm dhe të jashtëm.

“Falë ndihmës, ne kemi rritur kapacitetin e prodhimit me rreth gjysmë milioni litra në vit. Aktualisht prodhojmë rreth 2 milion litra verë në vit. Përpunojmë rreth 1,5 milion kilogramë rrush në vit, nga të cilët mund të prodhojmë 1,1 milion litra verë,” thotë Bejtullah Haxhimurati, bashkëpronar i ‘Biopakut.’

Investimi i fundit i bërë në teknologji ka rritur cilësinë e verës përmes stabilizimit të furnizimit, përpunimit dhe ruajtjes më të mirë. Prodhimi është rritur për 50 për qind.

“Asistenca e BE-së na ka ndihmuar të përmirësojmë gjithçka në kompaninë tonë dhe jemi mirënjohës për këtë. Nëse ka më shumë

“Falë ndihmës, ne kemi rritur kapacitetin e prodhimit me rreth gjysmë milioni litra në vit. Aktualisht prodhojmë rreth 2 milion litra verë në vit. Përpunojmë rreth 1,5 milion kilogramë rrush në vit, nga të cilët mund të prodhojmë 1,1 milion litra verë.”

**Bejtullah
Haxhimurati,
bashkëpronar i
‘Biopak’**



investime të tilla anembanë Kosovës, Kosova do të përmirësohet edhe më shumë”, shton Haxhimurati.

Për më tepër, ky investim ka ndihmuar edhe furnizuesit vendas - rreth 60 prej tyre - prej të cilëve 'Biopak' siguron rrushin. Secilit fermer iu ndanë 100 arka në formë granti, çka u ndihmoi të ruajnë cilësinë e rrushit gjatë transportit.

Sulejman Durguti furnizon 'Biopak' me deri në 12.000 kilogramë rrush në vit, nga 2 hektarë të vreshtave të tij.

“Kjo asistencë na ka ndihmuar edhe ne, sepse kemi lidhur një kontratë trevjeçare, kemi marrë arkat falas, si dhe kemi ndihmë gjatë transportimit, mbledhjes dhe klasifikimit. E gjithë familja ime është e angazhuar dhe kjo e ka ndihmuar shumë familjen tonë,” thotë Durguti.

Rreth 14 përqind e BPV-së së Kosovës vjen nga sektori i bujqësisë, i cili është punëdhënësi më i madh në Kosovë. Bujqësia është një nga çelësat për ndihmën e IPA II për shkak të potencialit të saj ekonomik. Sektori i bujqësisë punëson shumicën e popullsisë dhe llogaritet si burimi kryesor i të ardhurave për qytetarët e Kosovës. Sipas Dokumentit Strategjik Indikativ për Kosovën, IPA II kontribuon në rritjen e konsiderueshme të konkurrueshmërisë së bujqësisë dhe prodhimit të ushqimit në Kosovë, për të ngritur standardet e sigurisë ushqimore të produkteve vendore dhe për të përmirësuar standardet e jetesës së popullsisë rurale të Kosovës. Ky sektor gjithashtu ka potencial për rritje dhe eksport.

Mbi 100 km në veri të Rahovecit, në Leposaviq, Vlladan Millojeviq po bën përgatitjet përfundimtare për hapjen e një fabrike për prodhimin, përpunimin dhe eksportin e kërpudhave. BE-ja e ndihmoi me rreth 243.000 euro për ndërtimin e një objekti prej 600 m² për prodhimin e kërpudhave champignons (shampinjon).

“Kjo asistencë ishte e shkëlqyer. I jam shumë mirënjohës BE-së dhe shpresoj se do të vazhdojë të mbështesë bizneset. Kjo do të jetë e mirë jo vetëm për Leposaviqin, por edhe për tërë Kosovën veriore.”

Vlladan Millojeviq, prodhues i kërpudhave nga Leposaviqi.



Vlladanit dhe partnerit të tij, Ivan Milojeviq, iu erdhi kjo ide për shkak të mungesës së këtij produkti në tregun vendas.

“E gjetëm veten në këtë fushë. Aktualisht, nuk ka prodhues të tjerë të kërpudhave champignons (shampinjon), kështu që menduam se kjo është një ide e zgjuar,” thotë Vlladan Millojeviq.

Ai ka në plan t'i prodhojë vazhdimisht këto kërpudha, pasi ata do të jenë në gjendje t'i kultivojnë ato në katër dhoma të ndara.

“Ne duam që klientët tanë të jenë të kënaqur dhe të respektuar,” shton ai.

Kapaciteti i kësaj fabrike është prodhimi i 25 ton kërpudhave në një cikël prej 40 ditësh, ose i qindra tonve gjatë një viti.

“Veriu i Kosovës është i vogël për këtë kapacitet kështu që ne planifikojmë eksportin në Prishtinë, por edhe në Serbi: Novi Pazar, Rashkë, Kraljevë,” shton Millojeviq. Ndërkohë, plani i tij është që të punësojë 15 persona.

“Kjo asistencë ishte e shkëlqyer. I jam shumë mirënjohës BE-së dhe shpresoj se do të vazhdojë të mbështesë bizneset. Kjo do të jetë e mirë jo vetëm për Leposaviqin, por edhe për tërë Kosovën veriore,” thotë Millojeviq.

Forcimi i grupeve të cënueshme

ZYRA E BE-së NË KOSOVË / PËRFAQËSUESI I POSAÇËM I BE-së KA MBËSHTETUR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE (OSHC) PËRMES GRANTEVE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË GRUPEVE TË CËNUESHME, PROMOVIMIN E PËRFSHIRJES NË ARSIM, SI DHE PËR AFTËSITË E AVOKIMIT TË OJQ-ve TË NIVELIT BAZË PËRMES MEKANIZMIT TË GRANTEVE. NJË NGA PËRFITUESIT E KËTYRE GRANTEVE ËSHTË QENDRA PËR ZHVILLIMIN E GRUPEVE SHOQËRORE (CSGD) NË PRISHTINË.

Ndonëse Kosova ka një legjislacion të mirë për të drejtat e njeriut, zbatimi i tij paraqet sfida në të gjithë vendin.

Kjo është veçanërisht e theksuar me komunitetin lezbik, homoseksual, biseksual, transeksual dhe interseksual (LGBTI), i cili vazhdon të ballafaqohet me diskriminim, kërcënime dhe dhunë.

Qendra CSGD mbledh anëtarë nga komuniteti LGBTI dhe puna e saj është përqendruar në avokimin për të drejtat LGBTI, fuqizimin e komunitetit, si dhe në ngritjen e vetëdijes në shoqëri për çështjet LGBTI dhe parandalimin e HIV-it.

“Pengesja e parë me të cilën përballlet komuniteti LGBTI në Kosovë fillon brenda familjes, ku ata ndjejnë se janë nën trysni për të pasur një jetë të dyfishtë, ose ndonjëherë përballen me dhunë fizike ose psikologjike,” thotë Agim Margilaj, menaxheri i programit në CSGD. Në shumicën e rasteve, shton ai, dhuna nuk raportohet për shkak të ndjeshmërisë së saj.

Granti operativ i BE-së prej 60.000 eurosh për CSGD-në ndihmoi qendrën të zhvillojë strategjinë e avokimit dhe komunikimit, dhe falë saj, në vitin 2016, Qendra filloi të ofrojë ndihmë dhe asistencë ligjore për anëtarët e komunitetit që përballen me diskriminim ose

“Këto arritje për disa mund të duken si hapa fëmijësh, por për ne është një arritje e madhe që të kemi rastin e parë LGBT në të cilin institucionet e sundimit të ligjit po sfidohen me çështje nga vetë komuniteti.”

**Agim Margilaj,
menaxheri i
programit në
CSGD.**

dhunë për shkak të orientimit seksual.

Margilaj thotë se CSGD-ja është tani në gjendje t'i mbrojë para gjykatës anëtarët e saj nga homofobët.

"Ky është një nga shërbimet që çoi në rastin e parë në gjykatë në vitin 2016, kur një burrë homoseksual u sulmua në punë bazuar në orientimin e tij seksual. Ky rast tërhoqi vëmendjen e komunitetit dhe ua hapi derën të tjerëve për të raportuar përvoja të tilla. Pra pas këtij u raportuan edhe tri raste të tjera," shton Margilaj.

Për më tepër, rasti në gjykatë tërhoqi vëmendjen ndaj Kodit Penal të Kosovës, ku Qendra ka vërejtur boshllëqe të caktuara ligjore dhe tani është pjesë e grupit që punon në ndryshimet e neneve përkatëse.

"Këto arritje për disa mund të duken si hapa fëmijësh, por për ne është një arritje e madhe që të kemi rastin e parë LGBT në të cilin institucionet e sundimit të ligjit po sfidohen me çështje nga vetë komuniteti," shton Margilaj.

Qendra gjithashtu filloi bashkëpunimin me Universitetin e Prishtinës, me organizimin e disa ligjeratave dhe të një konkursi për ese. BE-ja gjithashtu ndihmoi në organizimin e marshit të vitit 2016 të aktivistëve LGBTI në Prishtinë. "Pas kësaj ngjarjeje, numri i komunitetit u rrit me rreth 60 individë, të cilët më pas u lidhën me CSGD-në," thotë Margilaj.

"Ndihma nga BE-ja është shumë e çmuar. Nuk kemi pasur avokat apo strategji të komunikimit, nuk kemi pasur jurist; nuk kishim zyrtar komunikimi apo zyrtar ligjor, i cili tani është duke analizuar çdo çështje ligjore dhe duke dhënë rekomandime. Nuk kemi pasur shërbime të tilla si ato psikologjike që tash ofrohen në Prishtinë dhe në qytete të tjera. Tani i kemi të gjitha këto falë këtij granti operacional," përfundon Margilaj.

IPA II mbështet Kosovën në edukimin dhe ngritjen e vetëdijes për të drejtat themelore dhe mosdiskriminimin, në mënyrë që të shihet një zbatim i plotë i angazhimeve në aspektin e anti-diskriminimit, duke përfshirë forcimin e mbrojtjes, promovimit, zbatimit dhe raportimit të të drejtave themelore në nivel lokal dhe

qendror.

Një shoqatë e paraplegjikëve dhe fëmijëve të paralizuar të Kosovës, HANDIKOS, është gjithashtu një nga organizatat që përfitojnë nga mbështetja e BE-së.

Një grant vjetor prej 60.000 eurosh, i cili parashihet të zgjasë për disa vite të ardhshme, i siguroi kësaj organizate fondet e parashikueshme kryesore për të mbështetur aktivitetet vjetore operative. Qëllimi i programit të punës është të mbështes HANDIKOSIN në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Afrim Maliqi, drejtor i HANDIKOS, thotë se kjo asistencë e ndihmoi organizatën të financojë katër persona në organizatë që planifikojnë aktivitetet vjetore të organizatës dhe që gjithashtu ndihmojnë njerëzit me aftësi të kufizuara.

“Me këtë ndihmë ne kemi arritur të punojmë shumë në fushën e të drejtave të njeriut në mesin e personave me aftësi të kufizuara, në ngritjen e vetëdijes, në avokim, lobim dhe ndikim të legjislacionit, si dhe në botime apo hulumtime.” thotë Maliqi.

“Ne mund të planifikojmë më mirë dhe mund t’i analizojmë më mirë nevojat e personave me aftësi të kufizuara,” shton ai.

Rezultatet janë shumë të dukshme. Gjatë vitit 2017, stafi punoi për të fituar një projekt me organizatën Save the Children, dhe ata patën sukses. Gjithashtu, organizata ka avokuar dhe lobuar për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe për këtë arsye arriti të nxisë një ligj mbi statusin dhe të drejtat e personave me paraplegji dhe tetraplegji, i cili po zbatohet aktualisht.

“Ky është grupi i rrezikuar i njerëzve me aftësi të kufizuara. Kam pasur më shumë kohë për të punuar për këtë dhe për të arritur të kemi ndikim,” thotë Maliqi.

Numri i personave me aftësi të kufizuara në Kosovë është i panjohur, por vetë organizata ka regjistruar rreth 18.000 persona të tillë. Maliqi beson se numri është shumë më i lartë.

Organizata zhvilloi edhe një projekt në Prishtinë në vitin 2016, kur pjerrina të improvizuara prej druri u vendosën në të gjithë qytetin, në mënyrë që njerëzit me aftësi të kufizuara të mund të kalonin pa asnjë problem. Qëllimi ishte të rritej ndërgjegjësimi për nevojën për t’u ndihmuar.

“Me këtë ndihmë ne kemi arritur të punojmë shumë në fushën e të drejtave të njeriut në mesin e personave me aftësi të kufizuara, në ngritjen e vetëdijes, në avokim, lobim dhe ndikim të legjislacionit, si dhe në botime apo hulumtime.”

Afrim Maliqi,
drejtor i
HANDIKOS.

Përkrahja e tolerancës përmes mbrojtjes së trashëgimisë

KOSOVA KA NJË TRASHËGIMI KULTURORE TË PASUR DHE TË LARMISHME, E CILA PËRFSHIN MONUMENTE, VENDE, ARTEFAKTE, POR EDHE ATRIBUTE TË PAPREKSHME TË KRIJUARA NGA TË GJITHË NJERËZIT QË KANË JETUAR NË KOSOVË PËR SHEKUJ ME RADHË.



Nëntor 2017 - Prishtinë, KOSOVË

Bashkimi Evropian është shumë i vetëdijshëm për ruajtjen dhe përmirësimin e trashëgimisë kulturore, dhe është i përkushtuar për ruajtjen dhe promovimin e saj. Gjatë planifikimit të asistencës IPA II, mbrojtjes së trashëgimisë kulturore iu kushtua vëmendje e posaçme.

Për të përmirësuar tolerancën ndër-komunitare dhe respektin për identitetin kulturor dhe trashëgiminë e të gjitha komuniteteve, si dhe besimin ndër-komunitar në nivel komunal, BE-ja vendosi të zbatojë në Kosovë një projekt për 'Ndërtimin e besimit përmes mbrojtjes kulturore,' të zbatuar nga UNDP-ja.

Një milion e gjysmë euro iu kushtuan pesë komunave në Kosovë për ripërtëritjen dhe zbukurimin e 18 objekteve të trashëgimisë kulturore, në mes tjerash xhami, kisha, varreza, muze etj. Qëllimi ishte gjithashtu rritja e angazhimit të komuniteteve në mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore dhe përmirësimin e kapaciteteve të organeve të zbatimit të ligjit për të mbrojtur objektet me rëndësi fetare dhe kulturore.

“Ky ishte një investim shumë i mirë dhe shumë i mirëpritur nga komuniteti dhe duam të falënderojmë të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë projekt.”
Xhevdet Bytyqi,
kryetar i
Bashkësisë Islame
në Lipjan.

XHAMIA HAXHI GANI SERMAXHAJ NË
KAMENICË



Projekti parashikoi edhe punëtori për të rinj për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, si dhe seanca të edukimit në shkollat e mesme për ngritjen e vetëdijes për nevojën për respektimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Projekti u zbatua në Rahovec, Gjilan, Ferizaj, Kamenicë dhe Lipjan.

Prifti i kishës ortodokse serbe të Shën Nikollës në Kamenicë, Dragisha Jereniq, thotë se kjo është një nga komunat e rralla në Kosovë ku shqiptarët, serbët dhe romët jetojnë së bashku, dhe jo të ndarë.

Asistenca e BE-së kontribuoi në renovimin e tre objekteve në Kamenicë: rindërtimin e parkut të qytetit, rinovimin e xhamisë Haxhi Gani Sermahaj dhe përmirësimin e oborrit të kishës së Shën Nikollës.

“Gjithçka ishte prishur këtu, ishte kalbur, dhe nuk mund të bënim asgjë për shkak të mungesës së financave” thotë Jereniq, duke treguar admirim për atë që është bërë në oborrin e kishës.

“Kishte një kompani shqiptare që punonte këtu, nuk kishim asnjë problem me ta, ata nuk kishin asnjë problem me ne. Ne këtu jetojmë bashkë, jo të ndarë,” shton Jereniq.

Ai beson se projekti i tij ka kontribuar në thellimin e marrëdhënieve të mira dhe respektit të ndërsjellë.

“Duhet parë parku i rinovuar i qytetit, ku fëmijët nga të gjitha komunitetet e ndryshme luajnë së bashku. Këtë nuk mund ta shihni shumë shpesh në vende të tjera në Kosovë. Ju duhet të vizitoni tregun e së premtës dhe të shihni si njerëzit punojnë dhe jetojnë së bashku këtu,” thotë Jereniq.

Nga ana tjetër, imami i bashkësisë islame të Kosovës, Bejtullah Hashani, vlerëson ndihmën e BE-së në rinovimin e xhamisë Haxhi Gani Sermahaj dhe pajtohet që projekte të tilla ndihmojnë në marrëdhëniet ndëretnike.

Rreth 60 km në perëndim të Kamenicës, në Lipjan, përmes të njëjtit projekt, është rinovuar oborri i xhamisë së qytetit Mulla Sherif Ahmeti si dhe një varrezë myslimane. Projekti gjithashtu përfshinte renovimin e kishës ortodokse serbe, Shën Flora dhe Laura.

“Mund t’i dëgjoje njerëzit përreth duke thënë “prifti ishte në xhami” ose “imami ishte në kishë”... Ata panë fotografi nga ceremonia e inaugurimit,”
Skender Mehmeti, imam i xhamisë së Lipjanit.



Kryetari i bashkësisë islame në Lipjan, Xhevdet Bytyqi, dhe imami i xhamisë, Skënder Mehmeti, pajtohen që projektet e tilla kontribuojnë në marrëdhëniet e mira të fqinjësisë.

“Ky ishte një investim shumë i mirë dhe shumë i mirëpritur nga komuniteti dhe duam të falënderojmë të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë projekt” thotë Xhevdet Bytyqi.

Ai shton se është bërë një punë e jashtëzakonshme në varrezat myslimane, që ishin në një gjendje shumë të keqe. Varreza tani ka rrethojë, shtigje të ecjes dhe është shumë më e pastër sesa ishte më parë.

“Ky projekt e bëri tolerancën shumë të dukshme, por ajo ekzistonte nga kohët e mëparshme. Dëshmoi se jemi të përkushtuar ndaj tolerancës dhe bashkëpunimit,” thotë Bytyqi.

Imami i xhamisë, Skënder Mehmeti, beson se ky projekt ka ndikuar shumë te komunitetet.

“Mund t’i dëgjoje njerëzit përreth duke thënë “prifti ishte në xhami” ose “imami ishte në kishë”... Ata panë fotografi nga ceremonia e inaugurimit,” thotë ai.

Jo larg nga xhamia, kishës ortodokse Shën Flora dhe Laura, të ndërtuar mes dy luftërave botërore, iu rinovua fasada, duke përfshirë dritare dhe dysHEME të reja, si dhe rrethoja, siç tregon prifti Sërgjan Stanković.

“Komuniteti serb, kisha ortodokse dhe unë personalisht jemi shumë të kënaqur me këtë projekt dhe rezultatet janë të mira. Fqinjët tanë, të cilët janë shqiptarë, janë gjithashtu të kënaqur,” thotë Stanković, duke shtuar se Lipjani është shembull i mirë i bashkëpunimit me fqinjët shqiptarë dhe i bashkëpunimit me komunën.

“Është shumë e rëndësishme që të punohet me të gjitha bashkësitë fetare në të njëjtën kohë. Më vjen keq që Kisha Katolike nuk ishte e përfshirë në këtë projekt, edhe pse në qytetin e Lipjanit nuk ka kishë katolike, por ata janë afër. Është e rëndësishme që ndihma të shpërndahet midis të gjitha komuniteteve,” përfundon ai.

“Gjithçka ishte prishur këtu, ishte kalbur, dhe nuk mund të bënim asgjë për shkak të mungesës së financave.”
Dragisha Jereniq,
krifti i kishës
ortodokse serbe të
Shën Nikollës në
Kamenicë.

Infrastrukturë më e mirë për një jetë më të mirë

NJË NGA INVESTIMET E BE-së QË PËRMIRËSOI KUSHTET E JETESËS NË KRYEQYTETIN E KOSOVËS, ËSHTË FABRIKA E RE E UJIT NË SHKABAJ, PRANË PRISHTINËS.

Prej kohësh Kosova është përballur me problemin e furnizimit të besueshëm me ujë të pastër. Për shkak të numrit të ulët të fabrikave të trajtimit të ujit dhe kapacitetit të pamjaftueshëm, të cilat përveç kësaj ishin në një gjendje të dobët, reduktimet e ujit ishin fakt i përditshëm. Sektori i ujit ka qenë një prioritet i lartë për BE-në në Kosovë dhe asistencë ka shkuar drejt rinovimit të fabrikave dhe stacioneve të pompimit, duke zgjeruar rrjetet dhe duke përmirësuar cilësinë e ujit.

Falë projektit në Shkabaj, Prishtina tani ka furnizim me ujë 24 orë. Kostoja totale e projektit ishte rreth 35 milionë euro dhe BE-ja e mbështeti me 5 milionë euro.

Qytetarët e rajonit të Prishtinës përballeshin me ndërprerjen e përditshme dhe të përnatshme të ujit nga viti 2000 deri në mars 2017, kur u hap fabrika e re e ujit. Përveç qytetit të Prishtinës, edhe qytete të tjera si Obiliqi, Graçanica, dhe Podujeva përfituan nga ky investim.

Kryeshefi ekzekutiv i Kompanisë Rajonale të Ujit 'Prishtina,' Ilir Avdullahu thotë se kjo fabrikë e re ishte një investim shumë i nevojshëm.

"Ajo zgjidhi një problem për rreth gjysmë milioni konsumatorë. Do të doja të falënderoja taksapaguesit evropianë të cilët u mundësuan qytetarëve të Kosovës të kenë furnizim me ujë 24 orë, me një cilësi shumë të mirë të ujit të pijshëm" shton ai.

Gjithashtu, fabrika e re ka punësuar 25 persona me profile të ndryshme që punojnë në tre ndërrime.

Përveç Shkabajt, gjatë vitit 2017 u përrua fabrika e ujit në Badovc. Rehabilitimi i fabrikës së ujit në Badovc ndihmoi familjet me furnizim të qëndrueshëm të ujit në Graçanicë dhe Prishtinë.

"Ajo zgjidhi një problem për rreth gjysmë milioni konsumatorë. Do të doja të falënderoja taksapaguesit evropianë të cilët u mundësuan qytetarëve të Kosovës të kenë furnizim me ujë 24 orë me një cilësi shumë të mirë të ujit të pijshëm."

Ilir Avdullahu,
kryeshefi
ekzekutiv i
Kompanisë
Rajonale të Ujit
'Prishtina.'



Nëntor 2017 - Prishtinë, KOSOVO

Por kjo nuk është e gjitha. Falë mbështetjes prej 10 milion eurosh, u ndërtua edhe një fabrikë për përpunimin e ujit në Shipol për rajonin e Mitrovicës, nga e cila përfitojnë rreth 250 mijë banorë të rajonit të Mitrovicës.

Në Leposaviq, BE-ja përmes projekteve për infrastrukturën sociale dhe ekonomike komunale, ka qenë në gjendje të ndihmojë komunën për t'u pajisur me fabrikën e trajtimit të ujit me pajisjet e nevojshme për të siguruar ujë të pastër të pijshëm, me një vlerë prej mbi gjysmë milioni eurosh.

Asistenca e BE-së në infrastrukturë ka një shtrirje të gjerë.

Teuta Podvorica, studente e mjekësisë së përgjithshme, përshkon çdo ditë rreth 14 kilometra rrugë deri në Lipjan, në mënyrë që të studiojë e qetë në bibliotekën e ndërtuar në këtë qytet. Ajo jeton në fshatin Kojksë.

“E përdor shumë, sepse aty gjej qetësi. Ka kabina private për të studiuar. Ka edhe dhoma të tjera më të mëdha për grupet e studimit. Vij shpesh, dhe qëndroj këtu për aq kohë sa është e hapur, deri në ora 19:00,” thotë Podvorica.



Asaj i duhet të zgjidhë transportin për në Lipjan, pasi nuk ka transport publik nga fshati i saj drejt qytetit. Megjithatë, kjo nuk e pengon që të vijë. Ajo është e bindur se nëse njerëzit e tjerë do të mësojnë për bibliotekën, ajo shpejt do të bëhet shumë e popullarizuar.

Teuta është një nga studentët e shumtë nga rajoni i Lipjanit që po shijojnë objektin e ri të Bibliotekës dhe Arkivave të financuar nga BE-ja, që kushtoi rreth 740.000 euro.

Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, Basri Hashani, shpjegon se Lipjani kishte nevojë të madhe për ndërtesën e re, pasi e mëparshmja ishte në gjendje shumë të rëndë. Vetëm 10 persona e vizitonin gjatë një muaji. Objekti i ri është ndërtesë trekatëshe prej 1500 m², e bollshme, me kabina private dhe një klasë të madhe për grupet e studimit.

“Tani mund të shohim një rritje të vizitorëve, pasi kushtet janë shumë më të mira. Është kënaqësi e vërtetë të shohësh që vijnë më shumë njerëz. Është një investim i dedikuar dhe i planifikuar,” thotë ai. “Kjo bibliotekë është vërtet çka i duhet qytetit tonë,” shton Basri Hashani.

“E përdor shumë, sepse aty gjej qetësi. Ka kabina private për të studiuar. Ka edhe dhoma të tjera më të mëdha për grupet e studimit. Vij shpesh, dhe qëndroj këtu për aq kohë sa është e hapur, deri në ora 19:00.”

**Teuta Podvorica,
studente nga
Lipjani.**

Shansi i dytë për të miturit e Kosovës

AKTUALISHT, JANË TETË TË MITUR TË DËNUAR ME MASA EDUKATIVE TË TRANSFERUAR NGA QENDRA KORREKTUESE E LIPJANIT NË QENDRËN E RE KORREKTUESE EDUKUESE PËR TË MITUR NË LIPJAN, TË FINANCUAR NGA BE-ja. NË KRAHASIM ME PËRVOJËN E MËPARSHME, ATA THONË SE QENDRA E RE U OFRON KUSHTE DHE SHANSE SHUMË MË TË MIRA.

Këtu më pëlqen më shumë. Kushtet janë shumë më të mira. Dhe këtu nuk ka hekurat, si tek tjetra. Ditët i kaloj duke luajtur basketboll, duke folur me miqtë e mi këtu,” thotë një nga të miturit.

“Mund të luajmë sport, mund të dalim të ecim sa herë që duam. I kalojmë ditët duke lexuar, duke shikuar televizor, duke luajtur pingpong, apo basketboll,” shton një tjetër.

Ata besojnë se do të kenë ndryshuar kur të dalin nga qendra.

“Në qendrën e mëparshme, nuk mund të përmirësoheshe. Lëvizja është e kufizuar, je pas hekurave, je vetëm dhe atëherë të vijnë të gjitha mendimet e këqija. Këtu është shumë më mirë. E kam përmirësuar edhe sjelljen time. E di që kur të dal nga këtu nuk do të jem personi që isha më parë. Gjëja më e mirë është që ne kemi shoqëri këtu, e kalojmë kohën së bashku,” thotë njëri prej tyre.

Deri jo shumë kohë më parë, të miturit e dënuar me masa edukative, të cilat nuk konsiderohen si dënime penale sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur (KDPM), trajtoheshin thjesht si të mitur të dënuar. Ata mbylleshin në një objekt të mbyllur në Qendrën Korrektuese në Lipjan, së bashku me të miturit e paraburgosur dhe të dënuar.

“Mund të luajmë sport, mund të dalim të ecim sa herë që duam. I kalojmë ditët duke lexuar, duke shikuar televizor, duke luajtur pingpong, apo basketboll.”

I mitur në Qendrën Korrektuese Edukuese në Lipjan.



Kjo ishte për shkak të mungesës së një strukture të hapur të specializuar, e cila do të ishte në përputhje me kërkesat e Kodit të Drejtësisë për të Miturit dhe standardet ndërkombëtare.

Por kësaj i erdhi fundi falë mbështetjes së BE-së për reformat gjyqësore. Një nga drejtimet në këtë fushë ishin reformat e drejtësisë për të mitur në Kosovë, të arritura përmes kornizës ligjore në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe përmirësimit të programit edukativ/trajnuës për të gjitha institucionet e përfshira në sistemin e drejtësisë për të mitur etj.

Sipas programit IPA 2013, drejtësia për të mitur është mbështetur më tej përmes ndërtimit të një objekti për të miturit, i cili pranon fëmijë prej pesë muajsh tashmë.

Faza e tretë e mbështetjes së BE-së për sistemin e drejtësisë për të miturit parashikoi asistencë prej 2,4 milionë eurosh. Falë saj, përballë Qendrës Korrektuese në Lipjan tani është një ndërtesë moderne dhe plot ngjyra, me klasa, fusha të brendshme dhe të jashtme të basketbollit, një sallon pritjeje me TV, dhoma gjumi dyshe me banjat e veta, objekte të tjera sportive dhe struktura të ngjashme. Të miturve u lejohet t'i përdorin këto pajisje gjatë gjithë ditës. Ata gjithashtu mund të përdorin shërbimet mjekësore dhe psikologjike brenda ambienteve. Ata punojnë gjatë ditës tre deri në katër orë, duke u kujdesur për objektin.

Asistenca e BE-së e mbështeti edhe zhvillimin dhe zbatimin e trajnimeve të nevojshme për këtë strukturë.

Mungesa e një institucioni të tillë ndikonte në masën në të cilën gjyqtarët ishin në gjendje të zgjedhnin një dënim të përshtatshëm dhe efektiv në interesin më të mirë të fëmijës.

“Sigurimi i shërbimeve mund të jetë një mundësi unike për këta të mitur që të kenë qasje në arsimimin e duhur, në aftësimin profesional dhe në krijimin e avantazheve konkurruese për punësim në tregun e punës.”
Ardian Klaiqi,
Zyrtar i Drejtësisë për Fëmijë në UNICEF.



Ndërtimi i një qendre të re të hapur edukuese dhe korrektuese, jo vetëm që do të kontribuojë në zbatimin e plotë të KDPM-së, por gjithashtu do të sigurojë që fëmijëve u garantohet mbrojtja dhe asistenca e duhur, mbikëqyrja, trajnimi arsimor dhe profesional, duke synuar riintegrimin e tyre në shoqëri.

Fokusi i objektit të ri do të jetë risocializimi përmes një programi të bazuar në arsim. Të gjithë të miturit do të ndjekin shkollën e tyre të rregullt në shkollat publike në komunat e përzgjedhura. Gjithashtu, do të ketë një program të rregullt të trajnimit profesional.

Arif Beqa, drejtor i Qendrës së Drejtësisë për të Mitur, thotë se Kosova kishte nevojë të madhe për këtë qendër, e cila përveç aktiviteteve ofron arsimim për të miturit.

“Fillimi është pak i vështirë, sepse nuk mund të themi se kemi arritur të gjitha objektivat tona, por kemi filluar me disa nga programet tona të risocializimit,” thotë ai.

Tashmë një përqindje e madhe e fëmijëve të transferuar në këtë qendër kanë dalë nga qendra për shkak të sjelljes së tyre shumë të mirë.

Beqa shton se suksesi i këtij projekti varet nga angazhimi i institucioneve të ndryshme, siç janë Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit, Ministria e Punës dhe institucionet e tjera. Ai beson se fëmijët së shpejti do të fillojnë të ndjekin mësimet edhe në shkollat lokale.

“Ky sektor i të miturve ka nevojë për një koordinim të mirë midis institucioneve,” përfundon ai.

Ardian Klaiqi, Drejtor i Drejtësisë për Fëmijë në UNICEF, organizata që e zbaton projektin, gjithashtu beson se objekti i ri duhet të vërtetojë se është i dobishëm dhe jep rezultate konkrete në lehtësimin e riintegrit social të fëmijëve.

“Sigurimi i shërbimeve mund të jetë një mundësi unike për këta të mitur që të kenë qasje në arsimimin e duhur, në aftësimin profesional dhe në krijimin e avantazheve konkurruese për punësim në tregun e punës,” thotë Klaiqi.

AUTORE:
AMRA ZEJNELI LOXHA

REDAKTORE:
FJOLLA ÇEKU SYLEJMANI
ZYRA E BE-së / PSBE-së

DIZAJNI:
**KOPERATIVA
COMMUNICATIONS**

FOTOGRAFIA:
ARBEN LLAPASHTICA
[FQ. 1,4,7,8,12,13,14,15,22,23,26,28,29]

SAMIR KARAHODA
[FQ. 5,21,25]

© ZYRA E BASHKIMIT EVROPIAN NË KOSOVË / PËRFAQËSUESJA SPECIALE E BE-së
KOPJIMI LEJOHET NËSE JEPEN INFORMATA PËR BURIMIN.

PËRKTHIMI DHE SH TYPI: ZYRA E BASHKIMIT EVROPIAN NË KOSOVË
/ PËRFAQËSUESJA SPECIALE E BE-së, 2017.



EUICC NË PRISHTINË

RR. NËNA TEREZË, NR. 63
10000 PRISHTINË, KOSOVË
TELEFONI: +381 (0) 38 25 99 99
E-MAIL: INFO@EUICC-KS.COM



ZYRA E BASHKIMIT EVROPIAN NË KOSOVË

RRUGA KOSOVA 1,
PRISHTINË 10000, KOSOVË
TELEFONI: +381 38 5131 200
E-MAIL: DELEGATION-KOSOVO@EEAS.EUROPA.EU

EUICC NË MITROVICËN E VERIUT

RR. "ÇIKA JOVINA" P.N.
MITROVICA E VERIUT 40000, KOSOVO
TELEFONI: +377 (0) 45 599 592
E-MAIL: MI@EUICC-KS.COM

WWW.EUICC-KS.EU

BE-ja për Kosovën:

PËRKRAHJA NË
RRUGËTIMIN DREJT
BASHKIMIT EVROPIAN



Projekt i financuar nga BE-ja, i menaxhuar
nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
dhe i realizuar nga Koperativa



EU INFORMATION AND
CULTURAL CENTRE